



**Përmbledhje poezish  
nga nxënësit e shkollës  
"Asdreni"**

Pejë, 2024

**PËRMBLEDHJE POEZISH NGA  
NXËNËSIT E SHKOLLËS  
ASDRENI**

Pejë, mars 2024

U përkujdesën për librin:

**Pranvera Berisha**

**Merita Hajdari**

**Merita Gashi Muriqi**

**Sevdije Rexhaj**

Kopertina:

**Lina Kelmendi**

Dizajni Grafik

**Berat THAÇI**

Shtypi: **FAB ADVERTISING**

Botues: **“Libri im”**

## PARATHËNIE

Lexues të nderuar! Përmes këtij libri, ju keni mundësi që të lexoni një përmbledhje të vjershave të shkruara nga nxënësit e shkollës SHFMU “ASDRENI” në Pejë. Duke parë vlerat e shkrimeve të poetëve të rinj të kësaj shkolle dhe talentin e tyre gjatë orëve mësimore dhe jashtë saj, ne mësimdhënësit e kësaj shkolle së bashku me përkrahjen e drejtoreshes së shkollës znj. Agime Lajqi mblodhëm poezitë e nxënësve dhe vendosëm t’i botojmë në një libër. Nxënësit e kësaj shkolle në vjershat e tyre shprehën idetë dhe mendimet e tyre për dëshmorët e rënë për liri, për ditët e festës së Pavarësisë së Kosovës e Shqipërisë, Ditën e flamurit kombëtar, mallin për ata që dhanë jetën për liri, mësuesit, fluturat, natyrën e bukur, stinët e vitit, natën, sjelljet e fëmijëve, për gjuhën shqipe, qytetin e bukur të Pejës, buzëqeshjen e nënës, librin, çfarë duan dhe çdo gjë tjetër e bukur që ata i rrethon. Shpresojmë që përmes këtij libri do të promovojmë vlerat e këtyre nxënësve dhe ti stimulojmë që këta nxënës në të ardhmen ti shohim si shkruar të suksesshëm edhe në vitet tjera në vazhdim!

Nga kjo shkollë nxënës që shkruajnë vazhdimisht poezi ka shumë por ne zgjodhëm disa prej më të talentuarve si: Veron Elshani, Aisha Papuqi, Belinda Jevriqi, Rejna Agusholli, Flutura Jahaj, Yllëza Gashi, Tringa Arifi, Enea Krasniqi, Lorea Islami, Rubina Studenica, Vesa Krasniqi, Sara Kastrati, Adriana Berisha, Loreta Pehlivani,

Leon Kurtaj, Rona Beqiraj, Aulon Nurboja, Erjon Rexhaj, Lea Kurtaj, Bertina Beqiraj, Jona Haxhiaj, Eda Krasniqi, Orgesa Morina, Elvir Boxhovi, Rubina Salihaj, Erelis Morina, Maria Tereza Daka, Lir Sahiti, Lis Sahiti, Medina Hoxha, Dora Agolli, Engjëll Muriqi, Vesa Krasniqi, Suela Nikqi, Sara Kastrati, Lidra Mala, Ariana Berisa, Elsa Jevriqi, Leona Hiseni, Arza Kurbogaj, Dëbora Zekaj, Emaa Sylejmani, Andi Muhaxheri, Stina Xhemajli, Anil Ademaj.

## 17 SHKURTI

Viti 2008 solli  
diçka të re në jetë.  
Shumë të priturën  
Pavarësinë Kosova e mirëpret.

Me flamur kombëtar  
me flamur shtetëror  
t'a ruajmë këtë ditë  
si më të shtrenjtën në vit.

Gjashtëmbëdhjetë vite liri e pavarësi  
gëzohu Kosovë me ne!  
Përpara në Europë do të dërgojmë  
Të ardhmen që të mësojmë.

*Rubina Studenica*

*Klasa: VI-4*



## URIME KOSOVË

17 Shkurti një ditë gëzimi,  
Gjithë Kosova hoqi trishtimin,  
Se s'ka kush më që ta kërcënoj,  
Se ka forca dhe policia ta mbroj.  
Thot Europa "Ta gëzoni shtetin"  
Shqipëtar për jetë dhe mot,  
Ti kujtoni dëshmorët e Kombit  
Lavdi t'ju thoni atyre për jetë e mot.  
Gjaku i tyre ju solli sot lirinë,  
Shijojeni ju thonë dëshmorët,  
Ti mbron tokat tona Ilire-Dardane.  
Që ta gëzojnë brez pas brezi fëmijët tanë.  
17Shkurti 2008 Kosovë, Shqipëria thërret,  
Urime pavarësinë se armiku nuk mundet  
më në këto troje të bëhet mbret,  
Se jemi të fort si gurë, nuk mund të na  
mposht neve armiku më kurrë!

*Lekë Etemi VI/3*



## PRANVERA

Sa shpejt shkoi dimri,  
mbushen zemrat plot gëzim,  
zbardhet dita herët,  
mbushet toka plotë gjelbërim.  
Çelin lulet plot hijeshi,  
zbukurojnë në çdo anë  
Këndojnë zogjtë për bukuri,  
dallëndyshet prapë shtegëtojnë.  
Kënga, loja s' ka të ndalur,  
Gazi i fëmijeve bënë jehonë,  
Qielli i kaltër buzëqeshë  
Dielli që të dal s'përton.  
Dhe një tjetër gjë këtë stinë e zbukuron,  
Emri i arsimtares sime që gjuhë shqipe na mëson.  
Është e bukur si pranvera me lule,  
freskinë e saj e lëshon,  
Me buzëqeshje e dashuri ajo gjithmonë na mëson.

*Furkan Avdyli VI/1*



## NJË DREJTORESHË SI TY

Si agimi i mëngjesit, që gjithë botën ndriçon  
Ashtu je dhe ti dritë e diellit,  
Drejtoresha jonë!

Një grua e fuqishme, lidere e së ardhmes,  
Udhëheqëse e së mirës, udhëheqëse e së mbarës.

Mësimin dhe edukimin e fëmijëve e more me pasion,  
E bukur, e mençur dhe e drejtë që punën shumë e don.

Rezultatet më të mira ka gjithmonë shkolla jonë,  
puna jote e pandalshme është sukses për ne dhe vendin  
tonë.

*Furkan Avdyli VI/1*



## 17 SHKURTI

Festë për gjithë shqipëtarët!  
Sa shumë vite kanë kaluar, derisa erdhi kjo ditë.  
Sa shumë njerëz janë flijuar, sa me mallë e kemi prit.  
Plot vuajtje, dhimbje, lot pati Kosova që të jetë e lirë sot,  
Pavarësinë ta gëzojë.  
Sa të gëzuar jemi sot që erdhi kjo ditë.  
Ëndrra e çdo shqiptari u plotësua;  
U bë Kosova Republikë!

*Furkan Avdyli VI/1*



## PRANVERA

Ka ardhur pranvera, zogjtë po këndojnë,  
e pemët plotë me lule lulëzojnë.  
Dielli ka nxjerr syrin e tij dhe po u thotë  
fëmijeve të dalin jashtë e të luajnë gëzimplot.  
Lulet, pemët, bari i janë bashkuar  
vogëlusheve në  
kërcimin e tyre.  
Në lëvizjen e gjetheve, në cicërrimat e  
zogjtë krijojnë një melodi relaksuese  
që çdo njeri do ta pëlqente.  
Fluturat shumëngjyrëshe janë lartë në qiell  
Kanë formuar fjalën Pranverë.  
Bletët punëtore hedhin polen e nektarë e petale  
lulesh mbi vogëlushët kërcimtarë.

*Furkan Avdyli VI/1*



## **PRESIDENTJA JONË E PARË**

Me 7 Prill 2011 ndodhi një mrekulli e rrallë,  
Atifete Jahjaga u bë Presidentja jonë e parë.  
Grua e çeliktë, zonjë e vërtetë  
E drejtoi një shtet me nder dhe dinjitet.

Besoi në popull, në forcën e vet,  
E deshi tërë vendi, i besoi një shtet!

Zonjë e nderuar dhe shumë e zgjuar,  
Për vendin tonë njeriu i qëlluar!  
Dhe pas shumë vitesh  
suksesi yt nuk ndalet.  
Për ty zonjë e nderuar, krenohemi që të kemi,  
dhe na rrofsh sa malet!

*Furkan Avdyli VI/1*



## VJESHTA

Vjeshta po troket dhe  
era fryen ngadalë.  
Lejleku po largohet  
pa thëne asnjë fjalë.  
Gjethet fluturojnë,  
gjelbërim më nuk mbartë.  
Natyra ndryshon ngjyrën,  
Nga e gjelbërta në të artë.  
Pemët plot janë mbush;  
Molla, dardhë e rrush.  
E gështenja të vogla mbushet toka  
Që i do çdo kush.

Lulet më s'kanë erë, por bukuria nuk humb  
Freskia e shiut në diell, të kënaq çdokund.

*Furkan Avdyli VI/1*



## NËNA IME

Ti moj dritë e bardhë,  
Ti moj nëna ime.  
Më rrite me mundim dhe me përkushtime.  
Si kur isha i vogël më dhe frymë e dashuri,  
Më mësove të jem punëtor,  
Dhe i etur për dituri.  
Më mësove si të flas, si të dua e të rrespektoj,  
Më mësove çdo fjalë, e fjalën e parë e thashë  
NËNË.  
Nëna më e mirë në botë  
Prania jote është bekim për mua,  
Do të jem gjithmonë me ty  
Edhe në shi edhe në borë sepse përherë unë  
do të dua.

*Furkan Avdyli VI/1*



## MACJA IME

Macja ime bukuroshe  
Është e bukur pikaloshe  
Më ka shok dhe shumë e dua  
Unë e mbroj dhe me të luaj.  
Kohë me të shumë kaloj  
Gjithmonë zemrën e gëzoj.

*Furkan Avdyli VI/1*



## LIBRI

Çdo gjë që kërkoj,  
aty do ta gjej,  
po e kërkova Qiellin,  
Aty do të gjej dhe Diellin.  
Dritë në errësirë  
Shoku im më i mirë.  
Çdo libër i botës,  
të lehtë  
na e bënë çdo punë të vështirë.

*Furkan Avdyli VI/1*




## SHKRUAJ

Kur shkruaj unë frymoj,  
Kur shkruaj unë gëzoj,  
Kur shkruaj unë jam i lirë  
Kur shkruaj unë jetoj.

Kur shkruaj unë mrekullohem  
Kur shkruaj unë gëzohem,  
Kam shkruaj, shkruaj dhe do shkruaj,  
Sepse shkrimi s më bën të vuaj.

Atdheu im  
Atdheu im i dashur,  
o sa shumë të dua  
Vjersha e tregime  
për ty gjithmonë do shkruaj.  
Jam krenar për ty  
Që jam biri Yt,  
Dhe armiku i përbetuar  
nuk mundi kurrë të na zhduk.  
Luftuan trimat shqiptarë,  
Me pushkë e nder gjithëmonë,  
Që flamurin dhe lirinë ne sot ta gëzojmë  
*Furkan Avdyli VI/1*



## 28 NËNTORI

28 Nëntori ditë e madhe  
për ne.

Në flamurin tonë shqiponja  
Bëri fole.

Tokë e larë me gjak, e shumë trima u flijuan.  
Lirinë e mëmëdheut me pushkë dhe nderë e  
luftuan!

Trimi Skënderbe me krenari luftoj,  
Që Shqipëria të jetë e lirë sot,  
Pavarësinë ta gëzoj!

Kujdestares time  
Faleminderit për çdo gjë,  
Që ti për ne e dedikon  
Puna jote me ne,  
është si puna e fëmijës me nënë.  
Ëmbëlsia dhe përkushtimi yt ndaj nesh,  
E kalon çdo kufi.  
Të kemi një kujdestare si ty,  
Është bekim dhe lumturi.  
Faleminderit për çdo fjalë që thua  
Kujdes dhe përqafime.  
Faleminderit, ti mësuese-kujdestarja Ime!

*Furkan Avdyli VI/1*



## DËSHIRA E FËMISË

Unë fëmija i urtë që gjithmonë punoj  
Armikun s' kam dëshirë  
As në ëndërr ta takoj.  
Dëshirë tjetër kam  
Që ne fëmijët të jetojmë të lirë,  
ti dëgjojmë prindërit ,  
e të na realizohet çdo dëshirë!

*Furkan Avdyli*



## KOSOVA

Kosova është shtet diku në botë  
Emrin e tij ia thonë Kosovë.  
E pasur me bukuri natyrore,  
E me monumente historike.  
Shteti i Kosovës ka shumë admirime.  
Vende të lashta me shumë hijeshi  
Kosova është për ne pasuri.  
Të dua Kosovë më shumë se veten time,  
Të dua çdoherë se ti më je lumturia ime.

*Stina Osmani VI/4*



## FLAMURI

Sa gëzim kam në këtë ditë të madhe  
Kur në shpirt festoj këtë festë kombëtare.  
I kuq me shqiponjë, i nxehtë si rrufe,  
Vjen ky flamuri im që ndër vite është me ne.  
Mburrem me të sepse ka histori  
Festoj me të se ka trimëri.  
Kjo festë e madhe, të gjithëve na bashkon  
Ky flamur i bukur të gjithëve na gjallëron.  
Urime festën o shqipëtarë anembanë,  
Gëzofshi e festofshi me flamurin gjithëkombëtar.

*Veron Elshani VI/4*



## NËNTORI

Kaluan shumë shekuj  
E këtë ditë festojmë  
Shumë e shumë vargje  
Heronjve ua kushtojmë.  
Flamur i kuq i Shqipërisë  
Është simboli ynë i lirisë.  
Gatuar me gjak të Arbërisë.  
Marigona e ka qëndisë.  
Moj motra Marigonë  
të lumtë ajo dorë,  
që qëndise flamurin  
Të valoj në Vlorë.  
Më 28 nëntor plaku mjekërbardhë  
Valoi Flamurin në dorë  
Dhe e ngriti në Vlorë.  
Mblidhet populli arbëror  
dhe e feston këtë përvetor.  
Kjo ditë e bukur ka hyrë në histori  
Është ditë e lumtur  
Në Kosovë e Shqipëri.

*Rejna Agusholli VI/3*



## ATDHEU IM

Atdheu im i dashur  
sa shumë që të dua  
Ti je dritë e bardhë për mua.  
Të dua me shpirtë dhe me zemër  
Të dua përjetë, më i bukuri emër.  
Shumë jetë u dhanë për lirinë tënde,  
Andaj je i bukur për ty s' gjej dot emër.  
Deri sa të mundem, për ty do të luftoj  
Që atdheun tim të lirë ta shikoj.  
Kudo që të shkoj s'kam pët të harruar  
Derisa të kem jetë  
Ty kam për të kujtuar!

*Diella Maraj VI/2*



## DITA E PAVARËSISË

Ditë e madhe, ditë gëzimi  
Ditë fatlume, ditë shpëtimi.  
E shumëpritur nga çdo shqiptar.  
Posi rrufe që vjen prej qiellit  
Në gjithë hapsirën e Dardanisë  
Posi rrezja e parë e diellit  
Shkëlqen dita e Pavarësisë.

*Veron Elshani VI/4*



## GJUHA SHQIPE

E ëmbël e lehtë, e bukur përjetë,  
Je ti gjuha ime, më e shtrenjta shqipja ime.  
Sa dëshirë kam kur të flasë, e sa dëshirë kur të ndëgjoj,  
Ti zemrën ma mbush plot me gaz.  
Prandaj me shpirt të dashuroj.  
Gjuha shqipe ishte, ishte dhe do të jetë  
Një ndër gjuhët më të bukura që kam njohur përjetë.


*Veron Elshani VI/4*



## KADRI ZEKA

Kadri Zeka djalë shkollar,  
Cep më cep dole faqebardhë,  
Mësove e luftove për trimëri,  
Por jeta ty të bëri padrejtësi.  
Ishe me shokë në Gjermani,  
Mendjen kishe gjithmonë për liri,  
Shkolla jote ty të priste,  
Kosova jote ty të thërriste.  
Tash që sot ti s je me ne,  
S ka njeri që ty s të njeh,  
Emri yt ka hyrë në histori,  
I madhi Kadri Zeka përjetësisht lavdi.

*Veron Elshani VI/4*



## FESTA E MADHE

Në tokën shqiptare  
Në jug të Shqipërisë  
Me 28 Nëntor  
Me pushkë në dorë.  
Ismail Qemali  
Së bashku me shokë  
Ngriti flamurin  
Të bashkuar fort.  
Aty bën betimin  
Të gjithë ishin tok  
Në trojet shqiptare  
Të jenë vet të zot.  
Kjo ditë e bukur  
Ka hyrë në histori  
Eshtë ditë e lumtur  
Në Kosovë e Shqipëri.

*Nida Spahija VI/3*



## FLUTURA

Flutur, flutur fluturake,

Endesh vërdallë

Në livadhe.

Fluturon kah ti don,

Për ushqim për strehim

Kudo ti shkon.

Fluturon në kaltërsi

me liri dhe krenari,

Jeton në paqe dhe qetësi

Duke kaluar shtëpi më shtëpi.

*Enea Krasniqi VI/2*



# KOSOVËS

Fjalë e ëmbël është liria,  
sot gëzon gjithë shqiptaria.  
Fjalë e shtrenjtë është Pavarësia,  
sot festojmë Kosova e Shqipëria.  
Kosovë e dashur, Kosovë shtet,  
e gëzofsh pavarësinë për shumë vjet.  
Do të ruajmë e do të ndërtojmë,  
të lirë gjithmonë të festojmë.



## DIELLIT

O yll i zjarrtë dhe i madh,  
diell i verdhë dhe i flaktë.  
Zgjohesh herët në mëngjes,  
për ta ngroh tokën e sheshtë.  
Lindja jote na gëzon,  
shpirtin tonë na ndriçon.  
Perëndimi yt është i bukur,  
që çdo sy e bën të lumtur.  
Diell i ngrohtë dhe bujar,  
fuqi të madhe Zoti të ka falë.  
Frymëzim tokës ti i jep,  
nga qielli i kaltërt atje lartë.  
Vitaminën D nga ti e marrim,  
Na i forcon eshtrat si luanit.  
Diell i bukur e ngjyrë artë,  
rritna neve e bëna të mbarë.

*Figena Gjickolli VI/4*



## LIKENET E GJELBËRTA

Mbi lëvore thurret një bimë,  
e cila e ka emrin liken.  
Zarzavate me myshk dhe fije,  
një valle e qetë, pylli merr frymë.  
Një harmoni në ato lidhet.  
Kërpudhat dhe algat, zbulimet sekrete.  
Mbi shkëmbinj dhe degë ato ngjiten,  
Ata këndojnë një këngë simbiotike.



## VJESHTA

Stinë bujare,  
Vesë e brymë  
mbushe bimët,  
zhvillove farët.  
Gëzove fëmijët  
Me shiun tënd.  
Peisazh të bukur  
i dhe natyrës  
me gjethe shumëngjyrëshe,  
mbulove dheun.

*Figena Gjokolli VI/4*



## LULËKUQJA

Lulëkuqe,  
moj burbuqe,  
ngjyrë kuqe,  
flakërrushe.

Lulëzon në livadhe,  
fusha e në male,  
nuk thahesh dot,  
se je bimë shumë-vjeçare.



## VAJZA

Muaj e vite fluturuan,  
T'u hodh shtati si selvi.  
Shend e verë ti hyn e del.  
Për ne je vetë lumturi.



## STINA E VJESHTËS

Shkoi vera, erdhi vjeshta  
Pemë të mira na sjellë vjeshta.  
Plotë me pemë e perime  
Sa gëzohet zemra ime.

Vjeshtë e artë plotë  
me ngjyra ne fëmijëve  
na qesh fytyra.

Nëpër fusha , nëper ara  
bujqit tanë bëjne gara  
Kush me shumë e kush  
më pak bujqësia për merak.

Edhe pak kohë na vjen  
dimri menzi s'presim nga  
gëzimi ,bora e bardhë  
për të rënë dordolecin  
bashkë t'a bëjmë.

*Flutura Jahaj VI/1*



## VJESHTA

vjeshtë e bukur  
e vjeshtë e artë  
me plot bukuri  
e bujqesi

natyrë e qetë  
e bukur fort  
me ngjyrë të artë  
dhe deshira plot

erdhi vjeshta  
me rrush e me bujq  
delni të gjithë  
se ju duam shumë!

*Tringa Arifi VI/4*



## 17 SHKURTI

Sa i bukur  
e sa i çmuar  
une ty të quaj  
mëmëdhe!

Vendlindja ime  
me plot hare,  
ne ty të duam  
o mëmëdhe!

Flamur i lartë,  
gjuhë e lashtë  
vend i bukur  
je ti Kosovë e artë.

Për ty luftuan  
e për ty u derdh gjak,  
që ti të festosh  
17 shkurtin sot!

*Tringa Arifi VI/4*



## 17 SHKURTI

Kur erdhi kjo ditë  
Askush se ka ditë  
Që një shtet do të lulëzojë  
E një komb do të festojë.  
U gëzua bota  
U gëzuam ne,  
Tani që të lirë  
Po festojmë për atdhe.

Urime Kosovë  
Këtë ditë të pavarësisë  
Tani jemi shtet  
E askush s'na godet.

Festoni o rini  
Sepse për ju po vi  
Me 17 shkurt do jem me ju  
S'ka kush që më ndan nga ju.



## ATDHEU IM

Të quaj Dukagjin  
se ti je atdheu im  
të quaj Rugovë  
se aty ma ruan të bardhën dëborë.

Të kam xhan  
se ti frymën ma mban  
pa ty s'mund të jetoj  
e aq më pak të mërgoj.

Të dua me zemër  
e me plot dëshirë  
të dua atdhe  
se pa ty s'kam fole.

*Veron Elshani VI/4*



## ATDHEU

Kosovë  
Ti tokë Dardane  
O atdhe  
Ti Shqipëri e madhe  
Për ty kurrë nuk ndalem!

Ti tokë e bekuar  
Gjaku ynë për ty  
Kurrë nuk u shua!

*Norik Berani VI/3*



## NËNA

Njeriu që na  
solli në këtë botë, njeriu  
që na dha jetë, njeriu që  
do të na gëzoj për jetë.  
Është nëna që kurrë nuk do të  
të lë të heq  
Është personi që të ndihmon  
në jetë, personi që ta bënë botën  
dritë e paqe.  
Andaj gëzoje këtë dashuri e lumturi  
deri në fund të jetës tënde!

*Emma Gashi VI/3*



## 17 SHKURTI

Vite, shpresë, javë e muaj  
gjak të derdhur për liri!

Tortura, shkelje dhe dëbime  
për të shtrejtën Pavarësi.

17 shkurt 2008

Ditë e madhe po troket  
Hedhin valle pleq e të ri  
Gëzuar të madhen Pavarësi.

*Diellza Goqi VI/1*




## 17 SHKURTI

Dita e lirisë dhe e  
e pavarësisë  
Kosovë!

Dita e madhe  
për Kosovën time,  
Plot me sakrifica  
e mundime.

Luftuan e luftuan  
që të kemi liri  
paqe e lumturi.  
Le ta gëzojnë këtë ditë mbarë kombi.

*Flutura Jahaj VI/1*



## 17 SHKURTI

Festoni me zemër të hapur dhe gëzim,  
17 Shkurti si një flamur që  
fluturon në liri.  
Një poezi e e vogël,  
për këtë  
ditë të jashtëzakonshme,  
kur dashuria  
shpërthen si një fllad në pranverë.  
Të jeni të lumtur, me dashuri në krahë  
udhëtim i përbashkët pa asnjë shqetësim.  
17 Shkurti, ditë e veçantë e njerëzimit  
kujtojmë çdo qast të bukur pas hidhërimit.

*Belinda Jevriqi VI/2*



## DITA E PAVARËSISË

Sa kohë ka kaluar derisa erdhi kjo ditë  
Sa shumë njerëz janë flijuar,sa shumë kemi pritë.  
Plot sakrifica e mundime, plot vuajtje e padrejtësi,  
Kaloj kjo Kosova ime, gjatë rrugës për Pavarësi.  
Vite e vite të tëra,trimat për liri luftuan,  
Ditë e ditë të tëra nënat lotuan.  
Sa e shtrenjtë sa e çmuar është për ne kjo ditë,  
Sa me mall e thërrasim Kosova Republikë!  
Ëndrra shekullore e shqiptarëve je Ti,  
Amaneti I atyre që ranë për liri!

*Bejza Budima VI/4*



## GJUHA SHQIPE

Gjuhë e ëmbël, gjuhë amtare  
Është gjuha jonë shqiptare.  
Gjuhë që e foli Skenderbeu  
E për të shkroi Naim beu.

Nga dora ne dorë u përcolle,  
Nga zemra në zemër u këndove,  
Nga fleta në fletë u shkrove,  
Rrugë të mundimshme Ti kalove.

Prandaj mos lakmoni gjuhë të huaj  
Se ajo kurrë nuk bëhet e juaj.  
Shkruani, shkruani e lexoni  
Gjuhën shqipe mos e harroni!

E ju shqiptarë  
Që jetoni në mërgim,  
Gjuhën shqipe mos ta harroni  
E keni obligim!

Të mësojmë shqipen  
Si gjuhë të parë,  
Mos të harrojmë  
Se jemi popull shqiptarë.

*Rejna Agusholli, Kl: 6/3*



## SYTË SI DETI

Sytë si deti  
Aq të bukur  
Si dallgë të kaltra  
Të errët si thellësia

Valëviten kudo  
Dhe sytë e tu  
Mbajnë bukurinë  
E njëmijë deteve.

*Leona Hiseni, kl.VII*



## LIBRI

23 Prilli dita e librit  
Dita më e veçantë  
Për jetën e njerëzimit  
Dhe dashurinë për librin

Mos e harro atë  
Kurrë për mësim  
Se të jep jetë  
Të bukur e përparim

*Lidra Mala, kl.VII*



## NJË SI UNË ...

Një si unë,  
me zemër të bardh  
krijon suksese  
Kurrë pa u ndal.

Një si unë,  
shfaqë ftohtësi  
Për të mos treguar  
Dobësi.

Një si unë,  
jam e para  
Në gara “lidere” më thonë  
Jo çdo kush e gëzon.

Një si unë,  
nuk kërkon vëmendje  
se aspak  
nuk më Mungon...

Një si unë,  
nuk të vjen nga pas  
Se vetën shumë vlerëson  
Një si unë, nuk përshtatet  
Se natyra nuk na lejon.

Një si unë,  
çdo ditë lufton  
Nuk lodhem, por vazhdoj  
Nuk trishtohem sepse shpresoj.



*Arza Kurbogaj, kl.VII*

## HESHTJA

Diku fjalët mungojnë,  
E diku fjalët burojnë.

Diku fjalët bërtasin,  
E diku fjalët mërgojnë.

Diku ka veç buzëqeshje,  
E diku çdo gjë mbetet në heshtje.

*Arza Kurbogaj, kl.VII*



## 7 MARS

Në shkollë hyra  
Si një nxënës i thjeshtë  
Në bashkëpunim  
Me mësuesen  
Dhe arsimtarët  
Diplomova me notën 10.

Me mësimet e tua  
Unë dashurova  
Me shpjegimet e tua  
Unë ëndërrova  
Me fjalët e tua  
Unë mendjen pasurova.

*Vesa Krasniqi, kl. VII*



## **BOTA**

Gjithçka ka ndryshuar  
Ishim më të lumtur  
Ishim më të mirë me njëri-tjetrin  
Kjo sikur është harruar.

Na duhet të na dëgjoj dikush  
Por nuk kemi çka të themi  
Më nuk lexojmë libra  
Por merremi me rrjete sociale.

Nuk duhet të harrojmë të japim dashuri  
Kjo është forca më e madhe që kemi  
Ne kemi diçka që asnjëri se ka  
Kemi një zemër të njomë.

E ardhmja është në duart tona  
Atë nuk duhet ta shkatërrojmë  
Le të arsimohemi  
Sepse botën do ta sundojmë.

*Dëbora Zekaj kl.VII*



## VAJZA E PANJOHUR

Një vajzë gjithmonë e shikoj  
Si e shikoj menjëherë e kuptoj  
Duket që diçka mendon  
Nëse rrin me të shpejt e kupton.

Sytë i ka ngjyrë të gjelbert  
Si pylli i dendur me lisa e lule  
Duket si e habitur kur të ndëgjon  
Por asnjëherë nuk të gjykon.

Duket si vajzë që rrallë gjindet  
Por më e mirë se ajo ska  
Kokën e ka të forte  
Por besimin vetëm ty ta tregon.

Njerëzit që nuk i don, i largon  
Dhe iu thotë në fytyrë atë që mendon  
Shaka me ty bën  
Dhe asnjëherë s'të harron, të kujton.

*Ema Sylejmani kl.IX*




## DALLËNDYSHJA

Dallëndyshe zog shtegtar  
Ikën në vjeshtë  
Pa e parë  
A thua pse vallë?

Ato erdhën nga largësia  
Arsyeja që t'ju bënin shoqëri  
Fëmijëve tek pediatria  
Dhe Tuanës tek infektologjia

Kurajo për shërim  
Dhe pranvera të vije  
Plot lulëzim  
Në vendin tim.

*Andi Muhaxheri kl.VII*



## 17 SHKURTI

Erdhi kjo ditë që me pa durim e prisnim  
Shikonim e dëgjonim për shtetin tonë  
Kjo ditë shumë na gëzoi  
Armiqët i hidhëroi.

Shumë fëmij vdiqën  
E masakrat s'u harruan  
Gjithmonë i kujtojmë  
Fal tyre festojmë.

Kosova është e lirë  
Të bashkuar festojmë  
17 shkurti  
Pavarësinë shënon.

*Ena Sylejmani kl.IX*



## KUJTIMI IM

U mbyll dhe ky kapitull  
Shpejt shkoi edhe ky  
Në oborrin e shkollës fillore  
Nuk po hymë më aty.

Na mungon klasa e kujtimet  
Shpejt iku kjo fëmijëria  
Kohë të bukura kaluam  
Unë dhe shoqëria.

Bankat janë të zbrazura  
E në tabelë veç një thënie  
e shkruar:  
“Do më mungosh shkolla ime  
Aty ku nëntë vite kaluam” .

Shpesh shkruanim poezi  
E ese për vendin tim  
i kujtoj me mall e në mendje  
Mbetet si kujtim.

*Stina Xhemajli kl.IX*



## 17 SHKURTI

Shkurti i dimrit të tetë  
Më i bukur me të vërtetë  
Shkurti i shekullit 21  
Që Kosovës i solli liri.

Luftuam ndër vite e shekuj  
As të gjallë e as të vdekur  
Na zgjoi nga gjumi i robërisë  
Pushka e trimave të lirisë.

Trima që nuk pa bota më parë  
Me gjak dhe zemër shqiptar  
Trima me besë dhe me nder  
Që dimrin e bënë Pranverë.

*Aanil Ademaj kl.IX*



## 17 SHKURTI

17 Shkurti dita e Pavarësisë  
Çdo njeri feston këtë ditë  
Çdo njeri me flamur në dorë  
Vallëzon dhe këndon.

Çdo njeri me ndjenjat e tij  
Shpreh dashurin e Pavarësisë  
Çdo fëmij me emocionet e tyre  
Thurrin himn dhe melodi.

*Elsa Jevriqi kl.IX*



## SINQERITETI

I sinqert unë jam  
Çdo gjë me zemër e kam  
Kur dikujt i premtoj  
Atë dua ta realizoj.

Fjalën e drejtë  
Çdo herë e kam  
Dhe padrejtësit  
si duroj dot.

Çdo fëmij të rritet i mbarë  
Kur thotë fjalën të mendon më parë  
Sinqeritetin ta ketë  
Derisa të jetë gjallë.

*Engjëll Muriqi kl.VIII.*



## NËNA IME

Zemra ime  
Jeta ime  
Më e bukura  
Në jetën time

Më ushqen  
Më edukon  
Si nëna  
Askush s'të don.

*Vesa Krasniqi kl.VII/3*



## PRANVERA

Pranvera është  
Stinë e bukur  
Kur lulet me ngjyra  
Shkëlqejnë në fusha.

Fëmijët gëzojnë  
Këndojnë me zë të lartë  
Luajnë me shpirtin e lirë  
Dhe zemrën e artë.  
Lulet e Pranverës  
Natyren lulëzojnë  
Me bukurin e saj  
Qieillin pushtojnë.

*Sara Kastrati kl.VII/4*



## KOSOVA

Ti Kosova ime  
Je atdheu im  
Jam shumë krenare  
E ndihem me gëzim

Sot Pavarësin  
Ne po festojmë  
Flamujt mbi çati  
Në çdo çast po valojnë

Dua të flas shqip  
Në çdo kohë  
E gjithmonë  
17 shkurti është festa jonë.

*Ariana Berisha kl.VII/1*



## **BOTA DREJT FUNDIT**

Bota është duke shkuar drejt fundit  
Njerëzimi po shkatërrohet  
Çdo vit që po kalon  
Gjendja më shumë po keqësohet

Në ditët e sotme  
Dashuria  
Respekti  
Vlerësimi  
Nuk janë më pjesë e jetës  
Në këtë botë sot  
Ka vend vetëm  
Për xheloz  
Inat  
Dhe njerëz që s'mund t'i ndahen urrejtjes

Asnjëri –tjetrit nuk ia don të mirën  
Ushqehen duke të parë keq  
Edhe po të shohin që je e lumtur  
Do të bëjnë të pamundurën  
Që të mos jesh

Çdo ditë ka skandale  
Gjërat e çmendura  
Janë bërë normale  
Të shpeshta janë bërë vrasjet  
Vetëm për pak pasuri  
E vret burri gruan  
I len jetima fëmijët e tij

Nuk ka më drejtësi  
Bota është bërë shumë e padrejtë  
T' pa fajshmit po vuajnë  
E fajtorët jetojnë të qetë

Njerëz pa ndërgjegje  
Ka vdek dashuria  
Marrin frymë kot  
Mend i kanë vetëm te pasuria

S'ka më knaqësi shpirtërore  
Jetojnë jetën për t'u marrë  
Lakmi të tjerët  
E gënjejnë vetën  
Sepse s'mund të përballën  
Me të vërtetën  
Kjo botë s'ka më asnjë vlerë.

*Loreta Pehlivani kl.IX*



## MALLI

Të dua ende si në ditën e parë  
Ike më le  
Në zemër më hape plagë

Prisja dashuri  
Pësova zhgënjim  
Ahh çfarë jete  
E urrej fatin tim

Momentet bashkë  
Mbeten e kaluar  
Nga kujtimet që s'mund ti heq  
Malli më ka kapluar

Për ty bëra të pa mundurën  
Asnjëherë s'më ke vlerësuar  
S'kam qenë kurrë naive  
Veç se të kam dashuruar

Ndihem bosh  
Jam e lënduar  
I bëjë pyetje vetës  
Pse t'kam besuar

Jam ende gjallë  
Por ndihem e vdekur  
N'këtë botë s'gjej dot lumturi  
Shpresoj të gjej në botën tjetër

Je gabimi më i madh  
S'mund ta mohoj  
Ditë e natë lotët rrjedhin nga sytë  
S'mundem ti ndaloj

I lutem zotit të madh  
Të më jep force  
Të dal nga kjo errësirë  
Ty të harroj  
Të gjej qetësi në shpirt  
Dhe jetën ta vazhdojë

*Loreta Pehlivani kl.IX*



## DO TË BËHEM...

Do të bëhem një milioner  
As vet nuk e di se si  
Po mbase një ditë papritmas  
Milionat nga qielli do t'më bijnë

S'është që po mundohem  
Por thjeshtë i ëndërroj  
Ende s'kam arrit asgjë  
Por të gjithë ëndrrat  
Ua tregoj

Kam arrogancë, injorancë  
Sjellje t'këqija pafund  
Shpeshherë flas kot  
Dhe s'më kundërshton askush

Shitem se kam karakter të fort  
E bëjë vetëm sa për sy e faqe  
T'marrë pak vëmendje  
Nga disa rrugaqe

Edhe shkel mbi gjërat  
Që kam thënë  
Por s'ka rëndësi  
Këtë gjë unë kam zakon  
Dhe më japin përparësi

*Loreta Pehlivani*



## NATA

Qiellin e errët  
E shndërrit hëna  
Hënën yjet e shoqërojnë

Atë natë  
Në orët e vona  
Pash që shiu po fillon

Dola nga dera e shtëpisë  
Pa e pasur iden se ku po shkoj  
Po siç më tha një ndjesi  
Mbase atë natë ty do të takoj

Teksa ecja në një rrugë  
Ku s'kishte njeri  
Fillova të mendoj  
Për mua e ty

Lotët filluan t'më rrjedhin  
U përziën me shi  
Kujtimet më ngjallin nostalgji  
Kohën kur ishim bashkë të dy

Ehh sikur të mund të ktheja kohën  
Shpesh këtë imagjinoj  
E di që s'ka kurrë për të ndodhur  
Unë ende shpresoj

Jam zhytur në një ndjenë vetmie  
Nga dita që ti s'je  
Ende nuk e di arsyen  
Pse mua më le

Isha future thellë në mendime  
E larë me shi e lot  
Papritmas dëgjoj zhurmë hapash  
Afër meje  
Kthej kokën  
E ty të shoh

Gjithçka që doja  
Në ato momente  
Ishte  
Edhe njëherë  
Të të përqafoja

Por sa desha ta bëja  
Zhurma e shiut  
Nga gjumi më zgjoi

Hapa sytë  
Fytyrën tënde e pash nëpër yje  
Gjithçka ishte një ëndërr

Nga shtrati u largova  
Edhe njëherë  
Si zakonisht  
Hënës i tregova  
Që edhe këtë  
natë  
Unë përsëri  
Për ty ëndërrova.

*Loreta Pehlivani*



## 17 SHKURTI

17 Shkurti

Dita e Pavarësisë

Çdo njeri feton këtë ditë

Çdo njeri me flamur në dorë

Valëvit atë me krenari

Çdo fëmij me emocione

Fillon të këndoj

Këngë për dëshmorët

Të rënë për liri.

*Elsa Jevriq kl. IX*



## 7 MARSI

Mësimet që i mësuam  
Edukim e arsimim  
Të gjitha na mundësoi  
Mësuesja jonë me përkushtim

Dijen që e pati  
Krejt na e fali  
Asaj iu bë zemra mal  
Për ne që mësuam pa u ndal

*Engjëll Muriqi kl.VIII/4*



## 8 MARS

Lule për 8 Mars  
Unë ty të dhurova  
Ty e shtrenjëta ime  
Shumë të përqafova

Me duart e tua  
Unë arrita në qiell  
Me zërin tëndë  
Shndërrita si diell.

*Suela Nikqi kl.VII/3*



## NËNËS

Si dielli kur del  
Është buzëqeshja e nënës,  
Si rrezja e diellit,  
Shqiimi i saj të ngrohë.

Në botë nuk ka  
Asgjë sikur në,  
Sepse tërë jëtën e saj  
ajo t'a kushton ty.

*Dora Agolli VIII/2*



## ATDHEU IM

Është një vend me shumë drita  
Ky është vendi ku u linda e u rrita  
Aty eca hapat e parë  
Aty thirri për herë të parë nanë,  
Aty mësova shkrim e lexim  
Dhe si ta dua atdheun tim.  
Ia mësova edhe historinë  
Deri sa e fitoi pavarsinë.

*Dora Agolli VIII/2*



## NËNA

Fjala nënë të ngroh shpirtin  
Aroma e saj të mbush me jetë  
E kur jam pranë saj  
S'dua të kem asgjë tjetër

Nëna ime sa shumë të dua  
Ti gjithmonë më këshillon mua  
E sa herë kam nevojë për ty  
Ti je me mua po aty

Dashuria jote vlen më shumë  
Se cdo gjë në këtë botë  
Prandaj të dua ty  
Nënë o dritë e jetës!

*Medina Hoxha VIII/4*



## PRANVERA

Gjelbrimi na erdhi  
Lulet në cdo vend  
Bilbili ia thot këngës  
Në cdo lis e deg

Prej dege në degë  
Fluturon me krenari  
Jeta po gjallëron  
Pranvera ka mberri

*Lis Sahiti VIII/4*



## NËNËS

Je dritë e diellit  
Qe më dhe guxim  
Më bëre të lumtur  
e më fale gëzimin

Me ty drita agon  
Mëngjesi është i bardhë  
Dimrin ma bëre verë  
Të dua e të puth në ballë

Kur ti më thërret  
Dashuria ime  
Mbushem plot me jetë  
E ngazëllen zemra ime

*Lir Sahiti VIII/2*



## DËSHMORËT

Ranë shumë trima për liri  
Për një shtet të lirë  
Si lum gjaku rrodhi  
Qe të ketë paqe n'ketë dhe

E nëse ndokush i harron luftëtarët  
Atij shqiptarë nuk i thonë  
Se ai ëshërë kundër vërtetësë  
Kunder paqes e lirisë

*Maria Tereza Daka VIII/4*



## GJEL DEMBELI

Një ditë pula e vogël  
Shkoi të një pemë  
Dy fiq i kish pema  
Po si kapte dot

Donte t'i këpustë  
Por nuk mundi dot  
Pa një gjel aty  
Që po rrinte kot

Shkoi të gjeli e i tha  
Mund të më ndihmosh  
Ti këpus këta fiq  
More gjel bardhosh

E gjeli dembeli  
Ti shkundte përtoj  
Ë me dorë si preki  
As që e provoj

*Erlis Morina VIII/4*



## MË RUAJ YLLIN TIM

Po të ecësh në sheshin tonë  
Ma ruaj yllin tim  
Po të shkelësh rrugën tonë,  
Ma ruaj yllin tim  
Po ta përcjellesh porosinë tonë  
Ma ruaj yllin tim  
Po të lozësh lojën si gjithmonë,  
Ma ruaj yllin tim  
Kurt ë humbësh shpresën tonë  
Ma ruaj yllin tim  
Kurt ë humbësh dashurinë  
Ma ruaj yllin tim  
Edhe gëzimin po ta humbësh gjithmonë  
Ma ruaj yllin tim

*Rubina Salihaj VIII/1*



## QYTETI IM

Këtu linda  
Këtu po rritem  
Këtu mësoj  
Këtu dua të jetoj

Këtu luaj  
Me shokët e mi  
Këtu shkollohem  
Me shumë dashuri

*Elvir Boxhovi VIII/2*



## NËNA IME

Në cdo hap, në cdo kënd  
Ti je ajo që më kupton më mirë  
Me dashurinë tënde të përhershme  
Me ndriqon si yll në errësirë.

Zëri yt më embëlsi  
Kudo më shoqëron  
Ti për mua je thesar  
Që kurrë nuk mbaron

Të falëndëroj për cdo gjë  
Kujdesin, dashurinë e pakufishme  
Andaj unë do t'ju bëj krenare  
Me sukseset më të mira

*Orgesa Morina VIII/4*



## MËSUESJA IME

E dashur mësuese  
E shtrejtë je për mua  
Të them me gjithë zemër  
Të dua, shumë të dua !...

Ti më mësove e edukove  
Rrugën e jetës ma udhëhoqe  
Ti më je si yll drite  
Mësuese e dashur mësuesja ime.

*Eda Krasniqi VIII/4*



## 7 MARSI

7 marsi sinonim  
I shkollës shqipe  
Po na vjen  
Me shumë kujtime

Mos të harrojmë  
Shkollën e parë  
Me të bukurën  
Qe kemi parë.

Pandeli Sotiri  
Mësues i shquar  
Të faleminderit  
Që gjuhën tonë na ke mësuar

*Bertina Beqiraj VIII/4*



## KUR QESH NËNA

Kur qesh nëna, shkëlqen dielli  
Kur flet nëna, rrezon hëna  
Kur s'flet nëna vrënsohet qielli  
Kur qan nëna, nuk del dielli

Lavdi Zot që nënë krijove  
Dhe botën me të bekoje  
Nëse bota s'do kishte nënë  
Nuk do kishte diell as hënë.

*Jona Haxhiaj VIII/4*



## SHQIPERIA

Erdhi dita e lirisë  
Hare e gëzim kemi anë e kënd

Dita e bekuar  
Është 28 nëntori  
Dita më madhështore  
E atdheut tonë.

Si ylberi pas shiut  
Erdhi pavarësia  
E shpalli plakun mjekërbardhë  
Ismail Qemali në Vlorë

Ky flamur valon  
Në trojet e shqiptarisë  
Kudo e festojnë  
Këtë ditë të lirisë

*Bertina Beqiraj VIII/4*



## MESUESES SIME

Të gjitha të mirat  
M'i mësove në jetë  
Je margaritar i cmuar  
Ta them me të vërtetë  
Mësuesja ime e dashur  
Ti jetën ma ndryshove  
Me mësimet e edukatë  
Rrugën ma ndricove

*Lea Kurtaj VIII/2*



## NËNA

Këtë ditë me gëzim plot  
E festojnë nënat kudo në botë  
Ti më rrite me gëzime  
Fort e dashur nëna ime

Kjo është dita e nënës tonë  
Që na rrit e edukon  
Na ushqen e arsimon  
Për gjithqka ajo mendon

Ninullat e saj  
Gjithmonë i mbaj në mend  
Ajo ka një zemer të madhe  
Qe për cdokënd ka vend.

*Erjona Rexhaj VIII/1*



## LIBRI

Librin unë shumë e dua  
Se shumë gjëra më mësoi mua  
E mbaj afër atë përherë  
Se ai është me shumë vlerë

Nga ti mësova shkronjat  
E numrat një nga një  
Nga ti çdo ditë mora  
Nga pak dituri

Se largoi nga vetja  
Atë asnjëherë  
Dua të kem pranë  
Si sot për çdo herë

*Aulona Nurboja VIII/4*




## PRANVERA

U hap qielli  
Iken retë  
Erdhi pranvera  
Me t'vërtetë

Pemët me behar  
E fushat plot barë  
Zogjët cicërojnë  
Terë ditën punojnë

Lulet ngjyra-ngjyra  
Buzëqesh fytyra  
Luan e qesh fëmija

*Rona Beqiraj VIII/4*



## DUA, DUA

Dua të jem zog  
Në qiell të fluturoj  
Dua të jem flutur  
Lulet t'i vizitoj

Dua i lirë  
Jetën ta jetoj  
Dua armiqësia  
Mos të ekzistoj

E dua diellin  
Dua dhe hënën  
Por më shumë në botë  
Unë e dua nënën

*Leon Kurtaj VIII/2*



## PERMBAJTJA

Parathënie .....	3
17 shkurti .....	5
Urime kosovë .....	6
Pranvera .....	7
Një drejtoreshë si ty .....	8
17 shkurti .....	9
Pranvera .....	10
Presidentja jonë e parë .....	11
Vjeshta .....	12
Nëna ime .....	13
Macja ime .....	14
Libri.....	15
Shkruaj .....	16
28 nëntori .....	17
Dëshira e fëmisë .....	18
Kosova .....	19
Flamuri .....	20
Nëntori .....	21
Atdheu im .....	22
Dita e pavarësisë .....	23
Gjuha shqipe .....	24
Kadri Zeka .....	25
Festa e madhe .....	26
Flutura .....	27
Kosovës .....	28
Diellit .....	29
Likenet e gjelbërta .....	30
Vjeshta .....	31
Lulëkuqja .....	32
Vajza .....	33

Stina e vjeshtës .....	34
Vjeshta .....	35
17 shkurti .....	36
17 shkurti .....	37
Atdheu im .....	38
Atdheu .....	39
Nëna .....	40
17 shkurti .....	41
17 shkurti .....	42
17 shkurti .....	43
Dita e pavarësisë .....	44
Gjuha shqipe .....	45
Sytë si deti .....	46
Libri .....	47
Një si unë ... ..	48
Heshtja .....	49
7 marsi .....	50
Bota .....	51
Vajza e panjohur .....	52
Dallëndyshja .....	53
17 shkurti .....	54
Kujtimi im .....	55
17 shkurti .....	56
17 shkurti .....	57
Sinqeriteti .....	58
Nëna ime .....	59
Pranvera .....	60
Kosova .....	61
Bota drejt fundit .....	62
Malli .....	64
Do të bëhem... ..	65
Nata .....	67
17 shkurti .....	70

7 marsi .....	71
8 marsi .....	72
Nënës .....	73
Atdheu im .....	74
Nëna .....	75
Pranvera .....	76
Nënës .....	77
Dëshmorët .....	78
Gjel Dembeli .....	79
Më ruaj yllin tim .....	80
Qyteti im .....	81
Nëna ime .....	82
Mësuesja ime .....	83
7 marsi .....	84
Kur qesh nëna .....	85
Shqiperia .....	86
Mesueses sime .....	87
Nëna .....	88
Libri .....	89
Pranvera .....	90
Dua, dua .....	91
Përmbajtja .....	92

*Falënderim i veçantë për kontribut dhe bash-këpunim të dhënë për realizimin e librit “Përmbledhje poezish” nga nxënësit, të cilët pasuruan librin me krijime letrare dhe artistike, mësimdhënësit e Gjuhës Shqipe dhe Artit Figurativ të cilët përkrahën nxënësit e tyre: Pranvera Berisha, Merita Hajdari, Merita Gashi Muriqi, Sevdije Rexha dhe Lulzim Goqi.*

*Veçanërisht e falendërojmë drejtoreshën e Shkollës “Asdreni”, Agime Lajçi për përkrahjen dhe krijimin e këtij libri, duke motivuar krijuesit e rinj brenda shkollës.*

